

## Shtojca 14

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data \_\_\_\_/\_\_\_\_/2016

Për : **KAJMAKU**, Adresa: Durres, Fushe Kruje, Lagjia Kastrioti, Pallati 16, Shk.2 kati 1,ap.9.

Procedura e prokurimit: Proçedurë “E Hapur” per Mallra.

Përshkrim i shkurtër i kontratës : **“Gjelberimi ne Qytet”**, me fond limit **16’666’000** leke, sasia sipas preventivit, afati **60 dite** .

Publikime të mëparshme(*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike. [Buletini Nr.34 date 29 Gusht 2016].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. GREEN FARM Sh.p.k**

**K74727401G**

Vlera 13’445’000 (trembedhjetë milion e katërqind e dyzet e pesë mijë)leke

**2. BOSHNJAKU. B**

**K72627402H**

Vlera 14’165’500 (katërmbedhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind )leke

**3. KAJMAKU**

**K83725201G**

Vlera 16’500’500 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind mijë e pesëqind )leke

**4. “SHPRESA” Sh.p.k**

**K67917301H**

Vlera 16’602’275 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë)leke

**5. KALESHI ALFA Sh.p.k**

**K19006209F**

Vlera 16’650’220 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e njëzet) leke.

**6. RETO**

Nuk ka paraqitur oferte.

Jane s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtem:

1. GREEN FARM Sh.p.k
2. BOSHNJAKU. B
3. “SHPRESA” SHPK
4. KALESHI ALFA SHPK

## 5. RETO

Per arsytet e mëposhtme:

- Ofertuesi **GREEN FARM Sh.p.k** me vlerë të ofertës 13'445'000 lekë, **nuk** ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentat e tenderit;

1- Per kriterin e kërkuar në DT;

l. Model Certificate fitosanitare që do të shoqërojnë mallin.

Ofertuesi GREEN FARM Sh.p.k ka paraqitur "Çertifikate fitosanitare e brendshme" të firmosur dhe vëlosur nga inspektori z. Dhimitraq Qorri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve të Shqipërisë, ku rezultoi se z. Dhimitraq Qorri në të njëjtën kohë është edhe punonjësi i ofertuesit GREEN FARM Sh.p.k i deklaruar në listat e paraqitura si dhe administratori i shoqërisë GREEN FARM Sh.p.k z. Ferdinand BANI ka deklaruar se drejtues teknik për realizimin e objektit do të jetë Ing. Agronom Dhimitraq Qorri.

2- Per kriterin e kërkuar në DT;

i. Certificate cilesie ISO 9001 e prodhuesit të mallit, shoqëruar me dokumentacionin argumentues për sigurinë (vertetësinë) e prodhimit të mallit.

Ka paraqitur certificate ISO 9001, por nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar dhe argumentuar prodhimin e mallit që kërkohet në dokumentat e tenderit.

3- Per kriterin e kërkuar në DT;

o. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës; të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik. për :

➤ Autobot uji 1 (një) copë

Autoboti i ujit me targa AA 539 KA i marrë me qera nga subjekti FUSHA shpk, rezultoi se ky autobot është paraqitur në institucionin tone nga vetë subjekti FUSHA shpk në të njëjtën kohë në një procedurë tjetër prokurimi, për të cilin ky i fundit është kualifikuar.

KVO vendos që ofertuesi të **mos kualifikohet**.

- Ofertuesi **BOSHNJAKU. B** me vlerë të ofertës 14'165'500 lekë, **nuk** ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentat e tenderit;

1- Per kriterin e kërkuar në DT;

f. *Një dokument të gjendjes financiare të leshuar nga një ose më shumë banka ku vlera e tyre të jete gjithësej jo më pak se 1'666'600 lekë. Leshimi i saj të mos jete bere me pare se 10 dite nga data e zhvillimit të tenderti,*

vertetimi i paraqitur nga ofertuesi BOSHNJAKU. B mban datën 02/09/2016, **nuk është brenda afatit të kërkuar**.

2- Per kriterin e kërkuar në DT;

h. *Subjekti duhet të jete i pajisur me:*

➤ *Certifikat: Sistemi manaxhimit të cilesise (ISO 9001)*

➤ *Certifikat: Sistemi manaxhimit të mjedisit (ISO 14001)*

- *Certifikat: Sistemi manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS-18001)*
- *Certifikat: Sistemi manaxhimit te transportit rrugor (ISO 39001)*

Certifikatat ISO te ofertuesit BOSHJAKU. B jane per mirembajtje te hapësirave te gjelberta(lulishte, pyllzime etj.) dhe jo per prodhim.

**3-** Per kriterin e kerkuar ne DT;

*i.Certifikate cilesie ISO 9001 e prodhuesit se mallit, shoqeruar me dokumentacionin argumentues per sigurine (vertetesine) e prodhimit te mallit,*

ofertuesi **BOSHJAKU. B** ka paraqitur nje Kontrate Furnizimi me personin fizik **Tafil Met Hasani** per tu furnizuar me lule natyrale, peme dekorative, farera dhe fidane, ISO 9001 e furnizuesit nuk eshte ne gjuhen e ofertes.

**4-** Ofertuesit **BOSHJAKU. B** i mungojne ;

*j. Licenca, Kodi III.7.A per "Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kulllotat"; leshuar nga QKL.*

*k. Licenca, Kodi II.4 per "Prodhimin dhe/ose tregtimi i farnave dhe/ose fidaneve"; leshuar nga QKL.*

*l. Model Certifikate fitosanitare qe do te shoqeroje mallin.*

*m. Operatori te disponoje ambjent per magazinimin e mallit.*

KVO vendos qe ofertuesi te **mos kualifikohet.**

- Ofertuesi **"SHPRESA" SHPK** me vlere te ofertes 16'602'275lekë, **nuk** ka permbushur kerkesat per kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit;

**1-** Ofertuesit **"SHPRESA" SHPK i mongon vertetimi** se i ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, per vitin 2016.

KVO vendos qe ofertuesi te **mos kualifikohet.**

**2-** Ofertuesit **"SHPRESA" SHPK i mongon** dokumenti i gjendjes financiare te leshuar nga një ose më shumë banka.

**3-** Per kriterin e kerkuar ne DT;

*h.Subjekti duhet te jete i pajisur me:*

- *Certifikat: Sistemi manaxhimit te cilesise (ISO 9001)*
- *Certifikat: Sistemi manaxhimit te mjedisit (ISO 14001)*
- *Certifikat: Sistemi manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS-18001)*
- *Certifikat: Sistemi manaxhimit te transportit rrugor (ISO 39001)*

Certifikatat ISO te ofertuesit **"SHPRESA" SHPK** jane per oastrim te brendeshme dhe te jashtme, lavanderi dhe gjelberim dhe jo per prodhim.

**4-** Per kriterin e kerkuar ne DT;

*i.Certifikate cilesie ISO 9001 e prodhuesit se mallit, shoqeruar me dokumentacionin argumentues per sigurine (vertetesine) e prodhimit te mallit,*

ofertuesi **"SHPRESA" SHPK** nuk ka paraqitur nje ISO e kerkuar.

**5-** Ofertuesit **"SHPRESA" SHPK** i mungojne ;

1. Model Certifikate fitosanitare qe do te shoqeroje mallin.

n. Operatori te disponoje ambjent per magazinimin e mallit.

KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet.

- Ofertuesi **KALESHI ALFA SHPK** me vlere te ofertes 16'650'220 lekë, **nuk** ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit;

Ofertuesit KALESHI ALFA SHPK te i mungojne ;

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional, Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 9 "Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

ç. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (afati për shlyerjen e detyrimeve do te llogaritet nga dita e hapjes së ofertës).

### 2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

a. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, per vitin 2016, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë kete dokument).

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

e. Një dokument të gjendjes financiare te lëshuar nga një ose më shumë banka ku vlere e tyre te jete gjithesej jo me pak se 1'666'600 lekë. Leshimi i saj te mos jete bere me pare se 10 dite nga data e zhvillimit te tenderit.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

i. Certifikate cilesie ISO 9001 e prodhuesit se mallit, shoqeruar me dokumentacionin argumentues per sigurine (vertetesine) e prodhimit te mallit.

l. Model Certifikate fitosanitare qe do te shoqeroje mallin.

- n. Operatori te disponoje ambjent per magazinimin e mallit.
- o. List pagesat sipas formulareve standarte per sigurimet, per muajin e fundit qe i takojne pagesat me daten e hapjes se ofertes, ku numeri mesatar i punonjesve te jete minimumi **15** persona, si dhe sipas vendimit nr.742, date 6.11.2003. Dokumenta te konfirmuara nga institucioni përkatës.

**Ofertuesi disponon 6 punonjes.**

KVO vendos qe ofertuesi te **mos kualifikohet.**

- **Ofertuesi RETO nuk** ka paraqitur oferte, KVO vendos qe ofertuesi **te mos kualifikohet.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se : **KAJMAKU**, Adresa: Durrës, Fushe Krujë, Lagjia Kastrioti, Pallati 16, Shk.2 kati 1,ap.9, me një vlerë të përgjithshme prej **16'500'500** (gjashtembedhete milion e peseqind mijë e peseqind është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Durrës ne njesine e prokurimit tel/fax 052 800 941 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtedhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.09.2016

Ankesa: ka ose jo \_\_\_ **Jo** \_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**Titullari i Autoritetit Kontraktor**  
**Vangjush DAKO**